



## Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu: Inovacioni dhe Inteligjenca Artificiale, thelbësore për transformimin e sistemit të mbrojtjes drejt “Mbrojtja 2030”



» faqe 3



### SHQIPËRIA RIAFIRMON ANGAZHIMIN NË ALEANCË: ZËVENDËSMINISTRJA ABRAZHDA NË MINISTERIALIN E MINISTRAVE TË MBROJTJES TË NATO-s

Zëvendësm ministrja e Mbrojtjes, znj. Blerina Abrazhda, mori pjesë në Ministerialin e Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s, që u zhvillua në Bruksel, ku u diskutua mbi sfidat aktuale të sigurisë, përparësitë strategjike të Aleancës dhe hapat për zbatimin e vendimeve të Samitit të Hagës...

» faqe 4



### QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT HAP DYERT ME PAMJE TË RE DHE KUSHTE MODERNE PUNE

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneraljtënant Arben Kingji, vizitoi sot godinën e rindërtuar të Qendrës së Personel Rekrutimit (QPR), e cila tashmë ofron kushte bashkëkohore dhe funksionale...

» faqe 2



### FJONGO ROZË MBI UNIFORMË: HISTORIA E GUXIMIT, SHPRESËS DHE RINGRITJES

Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,  
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në kuadër të Tetorit Rozë, muajt të ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit për luftën kundër kancerit të gjirit, sjellim një histori që frymëzon, prek dhe forcon besimin në forcën e njeriut për të përballuar çdo sfidë të jetës. Historia e nënkoloneles Esmihan Durbaku, është dëshmi...

» faqe 6

# Qendra e Personel Rekrutimit hap dyert me pamje të re dhe kushte moderne pune

**M**inistri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, vizitoi sot godinën e rindërtuar të Qendrës së Personel Rekrutimit (QPR), e cila tashmë ofron kushte bashkëkohore dhe funksionale për zhvillimin e aktivitetit të përditshëm.

Punimet, të realizuara në më pak se një vit, kanë përfshirë një sipërfaqe prej 3.700 metrash katrorë dhe kanë sjellë përmirësime thelbësore në të gjitha ambientet. Projekti ka pasur si synim modernizimin e infrastrukturës, përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjen e efikasitetit të shërbimeve që u ofrohen si personelit të Forcave të Armatosura, ashtu edhe qytetarëve.

Qendra e Personel Rekrutimit ofron sot edhe shërbime digjitale përmes Zyrës së Shërbimeve Online, ku vetëm gjatë muajit të fundit janë ofruar mbi 4000 shërbime në 7 kategori të ndryshme, të dedikuara për ushtarakët aktivë, ish-ushtarakët, civilët dhe qytetarët që kanë kryer shërbimin ushtarak.

Gjatë vizitës, ministri Vengu vlerësoi punën e kryer dhe theksoi rëndësinë e krijimit të kushteve dinjitoze për personelin ushtarak: “Më vjen mirë që jeni tashmë në kushte të rehabilituara, sepse një nga detyrat kryesore është përkujdesja për ecurinë e karrierës. Duhet të vijojmë me digjitalizimin e proceseve në mënyrë që rekrutimet, trajnimet dhe certifikimet të kryhen sa më transparente



dhe thjeshtë”, – u shpreh ministri Vengu.

Ai shtoi se digjitalizimi dhe meritokracia janë në qendër të reformës që po zbatohet në sistemin e Mbrojtjes:

“Me kushte më cilësore dhe me automatizimin e një pjese të proceseve, do të rrisim perceptimin dhe bindjen se në këtë strukturë ekziston meritokracia dhe secilit i jepet e drejta që meriton”, – theksoi ministri.

Ky investim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të Forcave të Armatosura, duke forcuar angazhimin e Qendrës së Personel Rekrutimit për të ofruar shërbime më cilësore, më transparente dhe në përputhje me standardet bashkëkohore të mbrojtjes kombëtare.

## Uells, Mbretëria e Bashkuar, 16 tetor 2025: Sukses i jashtëzakonshëm i Forcave të Armatosura në garën ndërkombëtare “Cambrian Patrol”



Shqipërinë ndër vendet më të suksesshme të këtij edicioni dhe është një dëshmi e përgatitjes, përkushtimit dhe nivelit të lartë të standardeve të trajnimit në Forcat e Armatosura.

Suksesi në “Cambrian Patrol” përbën

një arritje të rëndësishme për ushtrinë shqiptare, e cila me performancën e saj të shkëlqyer konfirmon aftësinë për të konkurruar denjësisht në arenën ndërkombëtare ushtarake, duke mbajtur lart me krenari flamurin kombëtar.

# Ministri Vengu: Inovacioni dhe Inteligjenca Artificiale, thelbësore për transformimin e sistemit të mbrojtjes drejt “Mbrojtja 2030”

**M**inistri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, zhvilloi një vizitë në Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes (QISM), ku u diskutua mbi hapat e ardhshëm në kuadër të strategjisë kombëtare “Mbrojtja 2030”.

Gjatë takimit me punonjës dhe ekspertë të QISM, ministri Vengu theksoi rëndësinë e aplikimit të Inteligjencës Artificiale si një instrument thelbësor për sintetizimin e informacionit, rritjen e efikasitetit operacional dhe zhvillimin teknologjik të Forcave të Armatosura në çdo nivel.

Në fokus të diskutimeve ishte gjithashtu mbështetja e industrisë së mbrojtjes përmes teknologjive inteligjente dhe zgjidhjeve inovative, të cilat do të mundësojnë krijimin e një strukture më moderne dhe të aftë për t’u përshtatur me sfidat e reja të sigurisë.

“Inovacioni është në qendër të vizionit tonë për transformimin e gjithë konstelacionit të Mbrojtjes në



një mekanizëm inteligjent dhe promotor të modernizimit”, – u shpreh ministri Pirro Vengu, duke theksuar angazhimin e

Ministrit për të ecur drejt një epoke të re teknologjike në sistemin e mbrojtjes.

Në takim u nënvizua përkushtimi i

Ministrit të Mbrojtjes për të avancuar teknologjitë moderne, për të forcuar kapacitetet kërkimore dhe inovative, si dhe për të ndërtuar një sistem mbrojtjeje të qëndrueshëm, efikas dhe të përgatitur për sfidat e së ardhmes.

Kjo nismë vjen si pjesë e procesit të modernizimit të strukturave të Forcave të Armatosura, në përputhje me objektivat e strategjisë “Mbrojtja 2030”, që synon ndërtimin e një infrastrukture mbrojtjeje të bazuar në teknologji të zgjuar, analiza të avancuara të të dhënave dhe zbatimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.



## Aktivitet ndërgjegjësues për reduktimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore

**N**ë kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC), në bashkëpunim me UNDP Albania dhe Bashkinë e Elbasanit, zhvilloi një aktivitet ndërgjegjësues në qytetin e Elbasanit, pjesë e fushatës kombëtare “Mbrojtja Civile në turne 2025”.

Në aktivitet morën pjesë Drejtori i Përgjithshëm i AKMC, z. Haki Çako, Kryetari i Bashkisë Elbasan, z. Gledian Llatja, si dhe përfaqësues nga Prefektura e Qarkut Elbasan dhe institucione të tjera vendore.

Gjatë aktivitetit, qytetarët u njohën me rëndësinë e parandalimit, përgatitjes dhe reagimit të koordinuar ndaj rreziqeve natyrore dhe situatave emergjente. Ata patën mundësi të informohen mbi mjetet e mbrojtjes, veprimet që duhen ndërmarrë në raste emergjente, si dhe rëndësinë e bashkëpunimit për



ndërtimin e komuniteteve të sigurta dhe të qëndrueshme.

Në kuadër të aktivitetit u ekspozuan pajisje të emergjencës, materiale ndërgjegjësuese, udhëzues praktikë dhe u zhvilluan aktivitete ndërvepruese që synonin rritjen e ndërgjegjësimit qytetar për reagimin në situata të rrezikut.

Në vijim, përfaqësuesit e AKMC-

së dhe partnerët zhvilluan një ndalesë në shkollën e mesme “Kostandin Kristoforidhi”, ku u organizua një simulim i një emergjence nga zjarri. Nën drejtimin e mësuesve, ekipeve të Zjarrfikësve, Shërbimit të Urgjencës Mjekësore dhe vullnetarëve të Kryqit të Kuq Shqiptar, nxënësit demonstuan procedurat e evakuimit dhe reagimit në

raste emergjente, duke treguar rëndësinë e njohjes së masave të mbrojtjes dhe vetë-ndihmës.

Ky aktivitet është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të AKMC-së dhe institucioneve partnere për të forcuar kulturën e sigurisë dhe për të ndërtuar një shoqëri më të përgatitur ndaj rreziqeve natyrore dhe emergjencave.



**Z**ëvendësministria e Mbrojtjes, znj. Blerina Abrazhda, mori pjesë në Ministerialin e Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s, që u zhvillua në Bruksel, ku u diskutua mbi sfidat aktuale të sigurisë, përparësitë strategjike të Aleancës dhe hapat për zbatimin e vendimeve të Samitit të Hagës.

Në fjalën e saj para ministrave të mbrojtjes të vendeve aleate, znj. Abrazhda vuri në dukje angazhimin e Shqipërisë për avancimin e prioritetëve kombëtare të mbrojtjes, në përputhje me objektivat e NATO-s dhe strategjinë e përbashkët të sigurisë.

“Jemi në një trajektore të qëndrueshme rritjeje të shpenzimeve të mbrojtjes dhe modernizimit cilësor, të shoqëruar me zhvillimin e kapaciteteve të montimit dhe integritit në zinxhirët e furnizimit të aleatëve, shtimin e aftësive mbrojtëse dhe reaguese, si dhe investime në qëndrueshmërinë kombëtare, përfshirë infrastrukturën kritike”, – u shpreh zëvendësministria Blerina Abrazhda.

Ajo nënvizoi se Shqipëria po vijon të kontribuojë në mënyrë aktive në misionet dhe operacionet e Aleancës, duke forcuar rolin e saj si një partner i besueshëm dhe i përkushtuar ndaj paqes dhe sigurisë kolektive.

Në përfundim të fjalës së saj, znj. Abrazhda përsëriti thirrjen për më shumë vëmendje politike dhe prezencë ushtarake të NATO-s në Ballkanin Perëndimor, me qëllim dekurajimin e reziqeve të sigurisë në Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë.

Ajo theksoi gjithashtu nevojën që çështja



## Shqipëria riafirmon angazhimin në Aleancë: Zëvendësministria Abrazhda në Ministerialin e Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s



e integritit të Kosovës në NATO të rikthehet në tryezën e diskutimeve, duke e konsideruar këtë si një hap thelbësor për sigurinë dhe stabilitetin e qëndrueshëm të rajonit.

“Shqipëria mirëpret rritjen e rolit dhe

angazhimin të NATO-s në strukturimin e marrëdhënieve me Kosovën, aspirata e së cilës mbetet integriti euroatlantik”, – përfundoi znj. Abrazhda.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në këtë



ministerial riafirmon angazhimin e vendit tonë ndaj parimeve të Aleancës, forcimin e kohezionit ndërmjet aleatëve, si dhe kontributin aktiv për një hapësirë euroatlantike më të sigurt dhe më të qëndrueshme.

**N**ë ambientet e Universitetit Kombëtar të Mbrojtjes të Turqisë, u zhvillua Konferenca e Dytë Ndërkombëtare Ballkanike me temë “Ndikimi i huaj dhe transformimi i forcave të armatosura në Europën Juglindore”. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të institucioneve akademike ushtarake nga vende të ndryshme të rajonit, mes tyre edhe delegacioni shqiptar, i kryesuar nga Prof. Asoc. Dr. Etleva Smaçi, zëvendës rektore e Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA).

Akademia u përfaqësua me tre kërkime shkencore që trajtuan tema me rëndësi strategjike për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare:

- “Evolucioni i bazës detare të Pashalimanit dhe rëndësia e saj strategjike” – Prof. Asoc. Dr. Etleva Smaçi
- “Gjeopolitika dhe arkitektura e sigurisë kombëtare gjatë periudhës ndër-luftërore” – Dr. Blerina Kuqi
- “Transformimi i Forcave të Armatosura Shqiptare gjatë 31 viteve të integritit euroatlantik” – Kol. (R) Dilaver Hoxha

Në konferencë mori pjesë gjithashtu edhe Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë, i përfaqësuar nga kolonel Arben Toska, i cili ndoqi nga afër punimet dhe diskutimet ndërkombëtare mbi çështjet e transformimit dhe bashkëpunimit ushtarak.

Gjatë aktivitetit, Prof. Asoc. Dr. Etleva Smaçi drejtoi panelin “Modernizimi dhe zhvillimi i forcës”, duke udhëhequr diskutimet me ekspertë dhe përfaqësues

## Akademia e Forcave të Armatosura dhe Kolegji i Mbrojtjes e Sigurisë, përfaqësojnë Shqipërinë në Konferencën e Dytë Ndërkombëtare Ballkanike në Stamboll



nga vende të ndryshme të Europës Juglindore mbi proceset e modernizimit të ushtrive dhe ndikimet e huaja në zhvillimin e forcave të armatosura. Në përmbyllje të konferencës, kryetarët e delegacioneve pjesëmarrëse nënshkruan një dokument mirëkuptimi

për forcimin e bashkëpunimit akademik dhe ushtarak në kuadër të rrjetit SEEN-IMHSS dhe procesit SEEDM, duke theksuar rëndësinë e bashkërendimit rajonal për siguri dhe paqe të qëndrueshme.

Kjo pjesëmarrje dëshmon angazhimin e



vazhdueshëm të Akademisë së Forcave të Armatosura dhe Kolegjit të Mbrojtjes e Sigurisë në nxitjen e kërkimit shkencor, shkëmbimin e përvojave dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

# Bashkëpunim i ngushtë me NATO-n për forcimin e mbrojtjes kibernetike

**S**hefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, priti në një takim pune zëvendësshefin e Shtabit të Komandës së Forcave Aleate në Evropë (SHAPE) për çështjet kibernetike, gjeneralmajor Reiner Beeck, i cili ndodhej në Shqipëri në kuadër të Konferencës së NATO-s për Mbrojtjen Kibernetike.

Gjatë takimit u diskutua mbi zhvillimet më të fundit në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë në fushën e mbrojtjes kibernetike, një ndër prioritetet strategjike të sistemit të mbrojtjes kombëtare.

Gjenerallejtënant Kingji vlerësoi rolin dhe angazhimin e Komandës së Kibernetikës dhe Ndërlidhjes, të cilat ndodhen në pararojë të përpjekjeve për forcimin e kapaciteteve mbrojtëse digjitale të Forcave të Armatosura, në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe sfidat e sigurisë moderne.

Në bashkëbisedim me gjeneralmajor Beeck, u theksua rëndësia e rritjes së bashkëpunimit me NATO-n në fushën



**“** GJENERALLEJTËNANT KINGJI VLERËSOI ROLIN DHE ANGAZHIMIN E KOMANDËS SË KIBERNETIKËS DHE NDËRLIDHJES, TË CILAT NDODHEN NË PARAROJË TË PËRPJEKJEVE PËR FORCIMIN E KAPACITETEVE MBROJTËSE DIGJITALE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, NË PËRPUTHJE ME ZHVILLIMET TEKNOLOGJIKE DHE SFIDAT E SIGURISË MODERNE.

e sigurisë kibernetike, për të garantuar mbrojtjen efektive të infrastrukturës kritike dhe rrjeteve të FARSH, si dhe

për të siguruar ndërveprueshmëri të plotë me standardet e Aleancës.

Gjenerallejtënant Kingji nënvizoi

se Shqipëria mbetet plotësisht e angazhuar në konsolidimin e këtij domeni të ri strategjik, duke synuar ngritjen e kapaciteteve të qëndrueshme dhe të afta për t'u përballur me kërcënimet kibernetike në rritje. Ky takim konfirmon përkushtimin e Forcave të Armatosura për të forcuar mbrojtjen kibernetike kombëtare dhe për të kontribuar në mënyrë aktive në sigurinë kolektive të Aleancës së NATO-s.

**Z**ëvendës Komandanti i Forcës Ajrore, Kolonel Luan Sadiku, në cilësinë e drejtuesit (Chairperson), drejtoi sesionin e 45-të të Agjencisë së Mbështetjes dhe Prokurimit të NATO-s (NSPA) për Komitetin e Avionëve me Krahë të Rrotullueshëm (RWA), i zhvilluar në Luksemburg.

Gjatë vitit 2025, Shqipëria mban kryesimin e këtij komiteti, duke forcuar rolin e saj në fushën e mirëmbajtjes dhe mbështetjes së helikopterëve të Forcës Ajrore në kuadër të strukturave të Aleancës. Ky drejtim përfaqëson një arritje të rëndësishme për vendin tonë, duke dëshmuar profesionalizmin, përkushtimin dhe aftësitë teknike të personelit shqiptar në forumet ndërkombëtare të NATO-s.

Në këtë sesion morën pjesë përfaqësues të vendeve aleate dhe partnere, të cilët diskutuan mbi rritjen e efikasitetit operacional, optimizimin e burimeve logjistike, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar për



## Shqipëria drejton sesionin e vjeshtës së NSPA për Komitetin e Avionëve me Krahë të Rrotullueshëm (RWA)



mbështetjen e platformave ajrore me krahë të rrotullueshëm.

Kryesimi nga Shqipëria në këtë strukturë thekson angazhimin e saj të vazhdueshëm në modernizimin e Forcës Ajrore dhe kontributin aktiv në iniciativat e përbashkëta të NATO-s, duke e pozicionuar vendin si një partner të besueshëm dhe të aftë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.



INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,  
Shefe e Sektorit të Botimeve

# FJONGO ROZË MBI UNIFORMË: Historia e guximit, shpresës dhe ringritjes

Me zemrën e një ushtarakeje dhe shpirtin e një luftëtareje:  
Historia e NËNKOLONELES ESMIHAN DURBAKU

**N**ë kuadër të Tetorit Rozë, muajit të ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit për luftën kundër kancerit të gjirit, sjellim një histori që frymëzon, prek dhe forcon besimin në forcën e njeriut për të përballuar çdo sfidë të jetës.

Historia e nënkoloneles Esmihan Durbaku, është dëshmi e gjallë se forca shpirtërore, vendosmëria dhe shpresa janë armët më të fuqishme në çdo betejë, qoftë ajo në fushën e detyrës, apo përballë një sëmundjeje që sfidon trupin dhe shpirtin.

Me një karrierë të gjatë dhe të respektuar në uniformë, nënkolonelja Durbaku është shembull i një gruaje që nuk është mposhtur nga vështirësitë. Ajo ka luftuar me dinjitet dhe guxim jo vetëm për atdheun, por edhe për jetën e saj, duke frymëzuar kolegë, familjarë dhe gra të tjera që përballen me të njëjtin realitet.

Përmes kësaj interviste, synojmë të përcjellim një mesazh fuqie, shprese dhe ndërgjegjësimi, se çdo betejë mund të fitohet, kur ka dashuri për jetën dhe besim në vetvete.

**Nënkolonele Durbaku, na tregoni pak më shumë për veten dhe rolin që mbani në Akademinë e Forcave të Armatosura.**

Faleminderit për ftesën dhe për mundësinë që të ndaj historinë time. Aktualisht jam me detyrë Pedagoge në Departamentin e Operacioneve Ushtarake, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë, ku prej shumë vitesh punoj me përkushtim për formimin e brezave të rinj të oficerëve. Kryejmë kurse dhe programe trajnimi për zhvillimin profesional të oficerëve, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së tyre në detyrë, avancimin në karrierë dhe përgatitjen për funksione e përgjegjësi në strukturat e Forcave të Armatosura si dhe në institucione të tjera. Roli im përfshin drejtimin, mentorimin dhe përgatitjen profesionale të oficerëve të rinj, por mbi të gjitha, është një mision për të transmetuar vlera si disiplina, përgjegjësia dhe dashuria për atdheun. Të jesh pjesë e kësaj akademie është nder dhe përgjegjësi, sepse aty formohen ata që nesër do të mbrojnë vendin tonë.

**Çfarë ju motivoi të zgjidhni një rrugë kaq sfiduese si ajo ushtarake, që kërkon disiplinë, sakrificë dhe përkushtim të vazhdueshëm?**

Që në rini kam ndjerë një thirrje të brendshme për t'i shërbyer vendit tim. Nuk ishte një zgjedhje e rastësishme ishte një vendim i vetëdijshëm për t'u bërë pjesë e një sistemi që ndërton karaktere. Më ka tërhequr gjithmonë ndjenja e drejtësisë, disiplinës dhe përkushtimit. Ushtria është një shkollë jete: të mëson të qëndrosh e fortë edhe kur gjithçka duket e vështirë. Më motivon ndjenja e misionit, e përgjegjësisë, dhe dëshira për të qenë shembull për vajzat që ëndërrojnë të ndjekin të njëjtin rrugëtim.

**Si e kujtoni momentin kur morët lajmin që do t'ju ndryshonte jetën?**

Ishte një ditë që do të mbetet përgjithmonë në kujtesën time. Lajmi erdhi papritur, në një periudhë kur jeta ime rridhte



Nënkolonele Esmihan Durbaku

mes punës dhe familjes. Kur dëgjova fjalët e mjekut, për disa sekonda gjithçka rreth meje humbi kuptim.

Ndjeva frikë dhe pasiguri, por shumë shpejt u ngrita. Thashë me vete: "Unë jam ushtarake. Kjo është beteja ime dhe do ta fitoj". Në atë moment vendosa të mos dorëzohesha, as para sëmundjes, as para frikës.

**Si ndikoi kjo përvojë në jetën tuaj personale dhe profesionale? A pati momente të dobësie apo pasigurie për të ardhmen?**

Sigurisht që po. Ka ditë kur forca të braktis dhe çdo hap duket i rëndë. Por vendosa të mos e lejoj sëmundjen të më përcaktojë kush jam. Në punë, vazhdova pa ndërprerje.



USHTRIA ËSHTË NJË SHKOLLË JETE: TË MËSON TË QËNDROSH E FORTË EDHE KUR GJITHÇKA DUKET E VËSHTIRË. MË MOTIVON NDJENJA E MISIONIT, E PËRGJEGJËSISË, DHE DËSHIRA PËR TË QENË SHEMBULL PËR VAJZAT QË ËNDËRROJNË TË NDJEKIN TË NJËJTIN RRUGËTIM.

Rutina, kolegët dhe ndjenja e misionit më dhanë energji. Në aspektin personal, kuptova se jeta nuk matet me sa kemi, por me sa dashuri japim. Çdo ditë u bë një dhuratë, çdo buzëqeshje një fitore e vogël.

**Cila ishte mbështetja më e madhe gjatë kësaj periudhe, familja, kolegët, mjekët apo forca juaj e brendshme?**

Të gjitha bashkë...

Familja ime ishte forca ime kryesore, më dhanë dashuri, besim dhe guxim.

Kolegët e mi më bënë të ndihesha pjesë e një familjeje të madhe, më qëndruan pranë dhe më motivuan. Mjekët më dhanë siguri dhe profesionalizëm, por në fund, forca më e madhe erdhi nga brenda vetes, nga dëshira për të jetuar, për të parë fëmijët e mi të rriten, për të vazhduar misionin tim në jetë.



SHOQËRIA DUHET TË FLASË MË SHUMË, TË INFORMOJË MË SHUMË, TË KETË FUSHATA TË VAZHDUESHME NDËRGJEGJËSIMI. FORCAT E ARMATOSURA JANË SHEMBULL PËR DISIPLINËN DHE KUJDESHIN NDAJ TRUPIT DHE MENDJES.

**Si e përballuat trajtimin dhe cilat ishin momentet më të vështira në këtë rrugëtim?**

Trajtimi ishte i gjatë dhe i lodhshëm, kimioterapi, ndërhyrje, radioterapi, analiza pa fund.

Ka pasur ditë kur trupi nuk kishte më fuqi, por shpresa nuk më la asnjëherë.

Në çdo errësirë gjente një dritë të vogël, një arsye për të buzëqeshur.

Çdo mëngjes, kur hapja sytë, falënderoja Zotin që isha ende aty, në betejën për të jetuar.

**A ju ndihmoi përvoja ushtarake për ta përballuar këtë sfidë shëndetësore?**

Absolutisht po. Ushtria më ka mësuar të mos dorëzohem, të ruaj qetësinë dhe të luftoj me strategji. Disiplina më ndihmoi të ndjek trajtimet me përpikëri, ndërsa organizimi më lejoi të menaxhoja më mirë emocionet.

Kjo përvojë ma kujtoi se uniforma që mbajmë nuk është vetëm simbol, por një mënyrë jetese që na jep forcë në çdo front, edhe në atë më personalin.

**Çfarë mësimesh të rëndësishme keni nxjerrë nga kjo përvojë? Si ka ndryshuar mënyra se si e shihni jetën dhe njerëzit?**

Kam mësuar se jeta është e çmuar dhe çdo moment duhet jetuar me vetëdije e mirënjohje. Kam rishikuar prioritetet e mia: familja, dashuria, shëndeti, këto janë pasuritë e vërteta.

Në punë jam bërë më e ndjeshme, më njerëzore dhe më e hapur ndaj emocioneve të të tjerëve. Kjo betejë më ka mësuar se çdo vështirësi mund të shndërrohet në mundësi për rritje.

**Çfarë mesazhi do t'u jepnit grave dhe vajzave që përballen me një sfidë të ngjashme?**

Grave do t'u thosha: mos kini frikë, mos humbni shpresën dhe mos e ulni kokën para sëmundjes. Besoni tek Zoti, tek mjekët dhe mbi të gjitha, tek vetja.

Kërkoni ndihmë, flisni hapur, mos u izoloni. Çdo hap drejt shërimit është një fitore.

Kjo sëmundje nuk është fundi, është një sfidë që mund të fitohet me dashuri, kujdes dhe besim.

**Si mund të ndihmojë shoqëria dhe Forcat e Armatosura në ndërgjegjësimin për parandalimin e kancerit të gjirit?**

Shoqëria duhet të flasë më shumë, të informojë më shumë, të ketë fushata të vazhdueshme ndërgjegjësimi. Forcat e Armatosura janë shembull për disiplinën dhe kujdesin ndaj trupit dhe mendjes.

Nëse ne, gratë në uniformë, tregojmë

kujdes ndaj shëndetit tonë, përcjellim një mesazh të fortë për të gjitha gratë shqiptare. Institucionet duhet të mbështesin kontrollet periodike dhe të krijojnë hapësira për diskutim e mbështetje psikologjike.

**Çfarë kuptimi ka për ju sot Tetori Rozë?**

Tetori Rozë për mua është muaji i jetës, i forcës dhe i reflektimit. Dikur ishte muaji i frikës dhe i dhimbjes, por sot është simbol i fitores, i bashkimit dhe i shpresës. Çdo fjongo rozë më kujton se jam gjallë, se kam luftuar dhe fituar, dhe se duhet të jem zëri i atyre grave që ende janë në betejë.

**Cili është mesazhi juaj për gratë shqiptare dhe koleget tuaja në uniformë?**

Grave shqiptare do t'u them: kujdesuni për veten, bëni kontrolle, mos e shtyni kujdesin për shëndetin tuaj. Ne kemi një forcë të brendshme që shpesh nuk e njohim deri në momentin kur sprovohemi.

Çdo hap i vogël drejt përmirësimit është një hap drejt jetës. Mos harroni – ju jeni më të forta se ç' mendoni, më të bukura se ç' besoni dhe më të vlefshme se ç' duket.

**Historia e Nënkoloneles Esmihan Durbaku është një thirrje për jetë, shpresë dhe solidaritet. Ajo na mëson se uniforma nuk mbulon vetëm trupin e një ushtarakeje, por edhe shpirtin e një gruaje që nuk dorëzohet.**

**Tetori Rozë na kujton se parandalimi shpëton jetë, se forca lind nga dashuria për jetën, dhe se çdo grua është një heroinë e heshtur në betejën e saj.**



ANJEZA MUSOLLARI,  
Shefe e Sektorit të Botimeve

Ruajtja e qetësisë dhe nderimit gjatë ceremonive apo ndeshjeve sportive nuk është thjesht formalitet, por shenjë edukate, vetëdijeje dhe përkushtimi ndaj vlerave që na bashkojnë si shoqëri.

Një popull që respekton flamurin dhe himnin e tij, e bën këtë sepse ka mësuar të respektojë flamurin dhe himnin e vet. Respekti ndaj flamurit dhe himnit nuk është detyrim, por ndjenjë që buron nga dashuria për atdheun dhe respekti për njerëzit.

### Simbolet kombëtare, shtylla e identitetit dhe dinjitetit shtetëror

Flamuri dhe himni kombëtar janë përtej protokollit ceremonial. Ato janë shpirti i shtetit, përfaqësues të gjakut, sakrificës dhe përpjekjeve shekullore për liri.

Respekti ndaj tyre është akt qytetar, shenjë vetëdijeje kombëtare dhe maturie politike.

Në çdo mjedis publik, nga ceremonitë ushtarake e deri te garat sportive ndërkombëtare, ngritja e flamurit dhe ekzekutimi i himnit janë momente që kërkojnë qetësi, respekt dhe solemnitet.

Këto parime vlejnë për çdo vend që aspirojnë të quhet demokratik e i civilizuar. Sepse respekti ndaj simboleve të tjetrit nuk e ul vlerën e tonës, përkundrazi e rrit atë.

### Kur mungon vetëpërmbajtja qytetare, rasti i stadimeve

Ngjarje të ndodhura në stadime ku një pjesë e tifozërisë fishkëllente dhe fyen gjatë ekzekutimit të himnit kombëtar të ekipit kundërshtar, nxerr në pah një plagë të vjetër në hapësirën ballkanike: mungesën e kulturës së respektit ndaj tjetrit. Një sjellje e tillë, pavarësisht emocioneve sportive apo ngarkesës historike, nuk mund të justifikohet.

Ajo nuk dëmton vetëm imazhin e vendit pritës, por shkon në kundërshtim me parimet ndërkombëtare të mikpritjes, sportivitetit dhe dinjitetit shtetëror.

Në arenën sportive, ku çdo gjest shfaqet para kamerave të botës, çdo fishkëllimë ndaj himnit të huaj është një shuplakë për qytetarinë.

### Sporti dhe arti si pasqyrë e pjekurisë shoqërore

Sporti dhe arti në të gjitha dimensionet e tij nuk janë fushë për konfrontime politike. Ato janë ura më e fuqishme që lidh popujt dhe kulturat.

Në çdo stadium, apo skenë kur ngrihet flamuri dhe dëgjohet himni, ai moment përfaqëson garën e ndershme dhe barazinë ndërmjet kombeve sovraane.

Fishkëllimat, fyerjet apo gjestet përçmuese gjatë atyre momenteve cenojnë vetë frymën e aktivitetit dhe janë në kundërshtim me rregullat e organizatave ndërkombëtare.

# Respekti ndaj flamurit dhe himnit kombëtar, pasqyrë e kulturës dhe dinjitetit të një kombi



ROLI I INSTITUCIONEVE ARSIMORE, MEDIAVE DHE LIDERËVE PUBLIKË ËSHTË I PAZËVENDËSUESHËM. EDUKIMI PËR DASHURINË NDAJ FLAMURIT DHE RESPEKTIN PËR SIMBOLET KOMBËTARE, DUHET TË NISË NË SHKOLLË DHE TË VAZHDOJË NË ÇDO HAPËSIRË PUBLIKE.

Për këtë arsye, federatat dhe autoritetet përkatëse duhet të reagojnë me masa të qarta disiplinore ndaj çdo akti që përbën fyerje ndaj simboleve shtetërore.

### Përgjegjësia morale dhe qytetare

Respekti ndaj himnit dhe flamurit të huaj është pasqyrë e edukatës kombëtare.

Ai tregon se një shoqëri është e vetëdijshme për vlerat e saj, për kufijtë e sjelljes dhe për dinjitetin që kërkon të përfaqësojë. Kur një komb di të respektojë tjetrin, ai automatikisht fiton respektin e botës.

Në këtë aspekt, roli i institucioneve arsimore, mediave dhe liderëve publikë është i pazëvendësueshëm. Edukimi për dashurinë ndaj flamurit dhe respektin për

simbolet kombëtare, duhet të nisë në shkollë dhe të vazhdojë në çdo hapësirë publike.

### Respekti si forcë, jo si dobësi

Respekti për flamurin dhe himnin kombëtar, qoftë të vetin apo të tjetrit, është akt fuqie morale dhe pjekurie kombëtare. Popujt që e kuptojnë këtë vlerë, ndërtojnë paqe, bashkëpunim dhe stabilitet. Ata që e shpërfillin, mbeten peng të së kaluarës dhe të armiqësive të kota.

Në fund të fundit, respekti për simbolet është respekt për vetveten.

Dhe aty ku ruhet nderi, ekziston gjithmonë shpresa për një të ardhme më të denjë, më të drejtë dhe më njerëzore.



# Fokus i NATO-s: Parandalimi, mbrojtja kundër dronëve dhe mbështetja për Ukrainën

Ministrat e Mbrojtjes të NATO-s, përfunduan takimin e tyre të parë që nga Samiti në Hagë të mërkurën, më 15 tetor.

Pas shkeljeve të fundit të hapësirës ajrore nga dronë dhe avionë luftarakë, ministrat diskutuan për forcimin e parandalimit dhe qëndrimit mbrojtës të NATO-s, duke përfshirë edhe përmes Eastern Sentry. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, theksoi gatishmërinë e Aleancës, duke deklaruar: “NATO është një Aleancë mbrojtëse. Ne do të mbetemi një Aleancë mbrojtëse. Por mos u gaboni - kjo Aleancë mbrojtëse është e gatshme të bëjë atë që duhet për të mbajtur një miliard njerëzit tanë të sigurt dhe territorin tonë të sigurt”.

Diskutimet nxorën në pah rritjen e investimeve në mbrojtje dhe përshtatjet inovative ndaj kërcënimeve në zhvillim. Duke u bazuar në incidentet e fundit, ministrat ranë dakord të zbatojnë masa shtesë kundër dronëve për të zgjeruar aftësitë e NATO-s. Kjo përfshin testimin e sistemeve të integruara kundër dronëve nën Eastern Sentry, si dhe nxitjen e bashkëpunimit me BE-në dhe sektorin privat për inovacion të shpejtë. Sekretari i Përgjithshëm vlerësoi reagimin e shpejtë, duke vënë në dukje: “Më parë këtë muaj, nëntë aleatë u mbledhën, së bashku me Ukrainën, për të mbështetur aftësinë e Danimarkës për t’u përballur me kërcënimet e mundshme nga dronët. Mendoj se ky është një shembull i fuqishëm i bashkëpunimit të shpejtë dhe efektiv që bëhet i mundur përmes NATO-s”.

Aleatët riafirmuan mbështetjen e palëkundur për Ukrainën, përfshirë gjatë një takimi të Këshillit NATO-Ukrainë me ministrin e Mbrojtjes të Ukrainës Denys Shmyhal dhe Përfaqësuesen e Lartë të BE-së Kaja Kallas, dhe më vonë në pasdite në Grupin e Kontaktit për Mbrojtjen e Ukrainës. Ndërsa Rusia vazhdon të shënjestrojë infrastrukturën civile përpara dimrit, Sekretari i Përgjithshëm nënvizoi rëndësinë e kontributeve të Aleatëve, duke thënë: “Mbështetja jonë për Ukrainën është thelbësore. Dhe do të vazhdojë e pandërprerë”.



## Aleatët e NATO-s forcojnë bashkëpunimin për trajnimin e liderëve të ardhshëm ushtarakë

13 Aleatë (Kanadaja, Çekia, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Italia, Holanda, Norvegjia, Spanja, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar) ranë dakord të fillonin zhvillimin e një aftësie trajnimi të simuluar shumëkombëshe.

Projekti i Trajnimit Sintetik të Shpërndarë me Dukshmëri të Lartë (HVP) synon t’i përgjigjet kërkesës gjithnjë në rritje për trajnim ushtarak shumëkombësh në një mënyrë me kosto efektive. Projekti do të shfrytëzojë aftësitë ekzistuese kombëtare të trajnimit të simuluar për të krijuar një rrjet të sigurt trajnimi virtual të avancuar dhe gjithëpërfshirës për qëllime shumëkombëshe.

Sapo të jetë i disponueshëm, aftësia do ta bëjë trajnimin shumëkombësh ndër-domen më të arritshëm dhe më pak të kushtueshëm, dhe do të zvogëlojë ndjeshëm kohën e përgatitjes për planifikimin dhe ekzekutimin e ushtrimeve.

Në një ceremoni nënshkrimi të mbajtur në Selinë e NATO-s në margjinat e takimit të Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s, Zëvendës Sekretarja e Përgjithshme Radmila Shekerinska vuri në dukje se: “Projekti do t’i përgatisë trupat tona për mjedisin dinamik dhe të rrezikshëm në të cilin ndodhemi dhe do të ndihmojë në sigurimin që të kemi forcat dhe gatishmërinë luftarake të nevojshme për të mbrojtur Aleancën”.

Iniciativat shumëkombëshe si Projekti i Trajnimit Sintetik të Shpërndarë me Dukshmëri të Lartë gjithashtu ndihmojnë në maksimizimin e përdorimit të aftësive të disponueshme në të gjithë Aleancën dhe më gjerë. Projekti është i hapur për pjesëmarrje nga Partnerët Indo-Paqësorë të NATO-s.

Aleatët pjesëmarrës dhe vendet partnere do të punojnë së bashku me Agjencinë e Mbështetjes dhe Prokurimit të NATO-s (NSPA) për zbatimin e projektit, duke përfshirë krijimin e një tregu që përputhet me nevojat dhe mundësitë e trajnimit të kombeve.



## NATO nis stërvitjen bërthamore të përvitshme “Steadfast Noon”

NATO filloi stërvitjen e saj vjetore të parandalimit bërthamor, “Steadfast Noon”. Stërvitja është një aktivitet trajnimi rutinë i planifikuar prej kohësh dhe pjesë e përpjekjeve më të gjera të NATO-s për të ruajtur gatishmërinë dhe për të siguruar transparencë rreth pozicionit të saj bërthamor. Nuk është e lidhur me asnjë ngjarje aktuale botërore dhe nuk përdoren armë të gjalla.

Duke njoftuar stërvitjen të premten, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mark Rutte tha: “Ne duhet ta bëjmë këtë sepse na ndihmon të sigurohemi që parandaluesi ynë bërthamor të mbetet sa më i besueshëm, i sigurt, i mbrojtur dhe efektiv”.

Holanda është vendi pritës për “Steadfast Noon” të këtij viti. Baza Ajrore Volkel do të jetë baza kryesore e fokusit për stërvitjen, me elementë të tjerë mbështetës në Bazën Ajrore Kleine-Brogel në Belgjikë dhe Forcën Ajrore Mbretërore Lakenheath në Mbretërinë e Bashkuar.

Stërvitja përfshin rreth 70 avionë nga 14 vende aleate, duke përfshirë një përzierje avionësh konvencionalë dhe me aftësi të dyfishta. Asetet mbështetëse përfshijnë mbikëqyrje, furnizim me karburant ajër-ajër dhe avionë komandë-kontroll. Një kontingjent i madh i mbështetjes konvencionale do të operojë nga Baza Ajrore “Skrydstrup” në Danimarkë.

Koloneli i Forcave Ajrore Amerikane, Daniel Bunch, Shefi i Operacioneve Bërthamore në Shtabin Suprem të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE), tha se organizimi dhe ekzekutimi i një stërvitjeje si “Steadfast Noon” kërkon një përpjekje të Aleatëve: “Në përgjithësi, ne po shohim afërsisht 2,000 personel që mbështesin drejtpërdrejt këtë stërvitje”, - tha ai.

Jim Stokes, Drejtori i Politikës Bërthamore i NATO-s, tha se stërvitja ka të bëjë me “promovimin e transparencës kur dhe ku është e përshtatshme, në mënyrë që popullatat tona aleate dhe bota në përgjithësi të kenë një kuptim të mirë të asaj që po bëjmë”. Pjesëmarrja në “Steadfast Noon” bëhet me rotacion midis Aleatëve çdo vit.



## Batalioni i Forcave Speciale, elita e Ushtrisë Shqiptare

Njësia më elitare e Forcave të Armatosura, Batalioni i Forcave Speciale (BOS), mbetet simbol i profesionalizmit, përkushtimit dhe sakrificës së djemve dhe vajzave që kanë veshur uniformën e saj. Për 25 vjet me radhë, kjo njësi ka qenë në vijën e parë të operacioneve më të ndjeshme brenda dhe jashtë territorit shqiptar, duke u renditur ndër njësitë më të vlerësuara të NATO-s në rajon.

### Krijimi i Batalionit të Forcave Speciale

Batalioni i Forcave Speciale u krijua me Vendim të Këshillit të Mbrojtjes nr. 2, datë 16 tetor 1998, me qëllim ndërtimin e një force elitë kombëtare të aftë për t'u përballur me sfidat e reja politike, ekonomike dhe ushtarake që vendi po kalonte pas viteve '90.

Në një kohë kur Shqipëria përballej me destabilitet dhe kërcënime të brendshme, nevoja për një njësi të specializuar ishte thelbësore. BOS u ngrit për të vepruar përtej operacioneve klasike konvencionale, me operatorë të aftë të vepronin në fshehtësi, me grupe të vogla, por me efekt strategjik të madh për interesat kombëtare.

Aktiviteti i parë i batalionit nisi më 24 shkurt 1999, në rajonin e Farkës, ndërsa sot njësia është e dislokuar në Zall-Herr, Tiranë. Komandanti i parë i batalionit ka qenë kolonel Hysen Ymeri, një nga zbuluesit më të mirë të Ushtrisë Shqiptare, i cili hodhi themelet e zhvillimit profesional të kësaj force.

### Struktura dhe rëndësia e Njesisë

Sipas doktrinave të NATO-s SOF, Forcat Speciale përbëjnë asete strategjike kombëtare. BOS është pjesë e Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS) dhe përbëhet nga kompani që mbulojnë të tre drejtimet operacionale tokë, ajër dhe det.

Njësia është e pajisur me teknologjinë më të fundit, që përfshin mjete të shikimit natën, kamera termale, pajisje lazer për armët dhe mjete motorike ujore moderne. Kjo i mundëson përmbushjen e tri detyrave bazë të forcave speciale: Aksione të drejtpërdrejta (AD); Asistencë ushtarake (AU); Zbulim special (ZS).

Forcat Speciale janë të përzgjedhura për nga aftësitë fizike, taktike dhe psikologjike, duke kaluar trajnime intensive për t'u përballur me operacione të ndërlikuara në kushte të vështira.

### Operacionet dhe Misionet Ndërkombëtare

Që prej krijimit, BOS ka marrë pjesë në një sërë operacionesh dhe misionesh brenda dhe jashtë vendit, duke dëshmuar profesionalizëm dhe besueshmëri të lartë në arenën ndërkombëtare.

1999 – gjatë konfliktit të Kosovës, njësia mori pjesë aktive në monitorimin e kufirit.

2001–2002 – veprimtari në bashkëpunim me Policinë e Shtetit për vendosjen e rendit kushtetues në Tropojë dhe monitorim kufitar në Maqedoninë e Veriut.

2003–2004 – operacione kundër trafikimit të qenieve njerëzore, drogës dhe armëve, në bashkëveprim me forcat e anti-terrorit.

2002–2004 – pjesëmarrje në misionet paqeruajtëse të ISAF në Kabul, Afganistan.

2005–2008 – misioni “Liria e Irakut”, Mosul, Irak.

2010–2014 – pjesëmarrje në misionet luftarake “Eagle” në Kandahar, Afganistan, duke realizuar 8 misione luftarake të suksesshme.

KFOR – Pejë, Kosovë – angazhim i vazhdueshëm në mbështetje të paqes dhe stabilitetit rajonal.

Në këto misione, operatorët e Forcave Speciale kanë përfaqësuar me dinjitet Shqipërinë, duke fituar respektin e aleatëve dhe duke ngritur lart flamurin kombëtar në mjedise ndërkombëtare.

### Sakrifica dhe Heroizëm

Në misionet e rrezikshme që ka ndërmarrë BOS, sakrifica nuk ka munguar. Një nga figurat më të nderuara është Dëshmori i Atdheut, Kapiten Feti Vogli, i cili dha jetën për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Heroizmi dhe përkushtimi i tij mbeten frymëzim i përhershëm për brezat e rinj të operatorëve specialë.



# 27 VJET KRENARI, SAKRIFICË DHE PËRKUSHTIM NË SHËRBBIM TË ATDHEUT

### Misioni dhe Vizioni

Në një botë ku kërcënimet janë gjithnjë e më të ndërlikuara nga sulmet hibride, lufta kibernetike e deri te dezinformimi dhe presioni psikologjik, Forcat Speciale të Ushtrisë Shqiptare janë të përgatitura të përballen me çdo sfidë.

Sot, Batalioni i Forcave Speciale mbetet pararojë e mbrojtjes kombëtare, duke ndërtuar rezistencë, qëndrueshmëri dhe partneritet në kuadër të Aleancës së NATO-s. Operatorët specialë, me përvojën e tyre të fituar në misione luftarake dhe paqeruajtëse, janë garanci e lirisë, sigurisë dhe prosperitetit të popullit shqiptar.



# "BIG BAND"

*"nde"z" amfiteatrin  
e Ligenit*



## ORKESTRA SIMFONIKE E FORCAVE TË ARMATOSURA

Në një mbrëmje të mbushur me emocion, art dhe atmosferë festive, amfiteatri i Ligenit Artificial të Tiranës u kthye në një skenë të gjallë ku muzika dhe qyteti u bashkuan në një festë të paharrueshme.

Me rastin e 10-vjetorit të krijimit të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit Tiranë, "Big Band" e Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhuroi një performancë të jashtëzakonshme, duke dëshmuar se arti ushtarak mbetet një vlerë e çmuar për jetën kulturore të vendit.

"Big Band" solli një repertor të pasur, ku u ndërthurën tingujt e jazz-it klasik me motive shqiptare dhe kompozime ndërkombëtare. Çdo pjesë muzikore ishte një rrëfim më vete, një udhëtim përmes emocioneve që ngrinin zemrat e publikut në të njëjtin ritëm me orkestrën. Publiku kryeqytetas, i mbledhur në numër të madh e përjetoj koncertin si një festë të vërtetë qytetare. Duartrokitjet e gjata, buzëqeshjet e ndritshme dhe vallëzimet



spontane krijuan një lidhje të gjallë mes skenës dhe spektatorëve, duke dëshmuar edhe një herë forcën bashkuese të muzikës.

Mbrëmja artistike ishte më shumë se një koncert, ishte një shembull i harmonisë së bukur mes artit, qytetit dhe shërbimit publik. Përmes tingujve të orkestrës, Forcat e Armatosura përcollën një mesazh të qartë: janë pranë qytetarëve jo vetëm në ditë sfidash, por edhe në momente gëzimi, reflektimi dhe frymëzimi kulturor.

"Big Band" e Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura, dëshmoi se uniforma mund të mbajë në vetvete jo vetëm disiplinën dhe forcën, por edhe artin, emocionin dhe shpirtin e kombit. Në fund të mbrëmjes, nën dritat që pasqyroheshin në sipërfaqen e liqenit, muzika u bë frymë, dhe fryma u bë festë. Falë "Big Band" dhe përkushtimit të Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura, Tirana jetoi një natë që do të mbetet gjatë në kujtesën e saj, një simfoni e vërtetë në zemrën e qytetit.





Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

# Nga kujtimi në përjetësi: historia e një ushtaraku me shpirt të fortë



## Kur kujtimet marrin frymë sërish - Miqësia që s'u plak kurrë

Koha ikën si një lumë i madh, që rrjedh pa u ndalur, por disa stacione të jetës mbeten të gdhendura thellë në kujtesë. Një nga këto stacione ishte takimi im me Pandi Papën, pas më shumë se dyzet vitesh. Mu duk sikur ai takim nuk ishte i sotni, por një rikthim i papritur nga koha e rinisë, nga vitet kur shpresa dhe energjia na përshkonte të gjithëve si një frymë e përbashkët.

Takimin ma mundësoi miku im, ushtaraku Sefedin Menkshi, në Pogradec, aty ku po kaloja disa ditë të qeta. Sa u përqaftuam, biseda na çoi menjëherë prapa në kohë, tek ditët e para të shkollës ushtarake, ku gjithçka kishte rëndësi – qoftë edhe një fjalë e thjeshtë inkurajimi. Pandi solli në kujtesë figurën e Bardhyl Hoxhës, atëherë sekretar i rinisë, sot gjeneral i ushtrisë, dhe kujtoi me mirënjohje kujdesin që tregoheshin për studentët e rinj të degës së zbulimit. Ishte një kohë kur dija, përgatitja fizike dhe morali i fortë ndërthureshin në një.

Në fjalët e tij ndjeva një nderim të veçantë për pedagogët e asaj kohe, për kuadrot e zbulimit, të taktikës, të fizkulturës... dhe sidomos për komandantin e shkollës, Rustem Peçi, që gjendej gjithnjë pranë studentëve, si një udhërrëfyes i heshtur, por i sigurt.

Pastaj, si për të mbyllur rrethin e kujtimeve, ecëm së bashku në rrugën që mban emrin “10 Dëshmorët e Pojskës”. Ecnim ngadalë, sikur koha donte të na jepte pak më shumë minuta për t'u kujtuar. Mbërritëm në një shtëpi të thjeshtë, me një bahçe të mbushur me pemë dhe zarzavate. Aty kaluam një pasdite të qetë, ku bisedat shkonin nga kujtimet tek sfidat e jetës, nga respekti për miqtë tek përkushtimi ndaj detyrës. Ishte një mbrëmje e ngrohtë, e mbushur me mirënjohje, si një poezi e vogël që shkruhet vetëm një herë në jetë.

## Pandi Papa – udhëtimi i një jete me dinjitet

Historia e Pandit është si një udhëtim me stacione të shumta, plot me vështirësi, por edhe me dritë. Ai lindi më 10 tetor 1963, në fshatin Kallamas të Korçës. Në vitet e rinisë, pas arsimit të mesëm, ndoqi Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve në Tiranë (1983–1986), ku u formua si oficer i zbulimit. Përfundoi me rezultate të shkëlqyera dhe zotëroi disa gjuhë të huaja – anglishten, maqedonishten dhe serbo-kroatishten – si mjete të domosdoshme për punën e tij të ardhshme.

Pas studimeve, shërbeu si shef i zbulimit në Brigadën e Këmbësorisë në Pogradec (1986–1989), e më pas si shef i seksionit të zbulimit në Divizionin e Këmbësorisë (1990–1993). Gjatë kësaj periudhe mbajti edhe detyrën e anëtarit, përkthyesit dhe nënkryetarit të komisionit kufitar dypalësh Shqipëri–Maqedoni, për incidentet kufitare në sektorin nr. 2, një detyrë e vështirë dhe me përgjegjësi të lartë.

Por jeta nuk është gjithnjë një shteg i drejtë. Nga 1993 e në vazhdim ai u gjend i liruar nga detyra, për shkaqe jashtë vullnetit të tij. Megjithatë, Pandi nuk u përkul: pranoi çdo punë që iu ofrua, duke e treguar veten si njeri të palodhur e të vendosur.

Më vonë, në vitet 2006–2008, punoi pranë një kompanie të ruajtjes fizike në Pogradec. Nga 2017 deri në 2023, ai iu

rikthye Forcave të Armatosura, si specialist rekrutimi në zyrën e mobilizimit të qarkut Korçë, pranë Bashkisë së Pogradecit. Ndërsa, që nga fillimi i vitit 2025, mban detyrën e specialistit të drejtimit/informacionit dhe emergjencave në sektorin e policisë pranë IEV Penale Pojskë, Pogradec.

Jeta e Pandit është një dëshmi e gjallë se njeriu nuk matet vetëm me shkëlqimin e posteve që ka mbajtur, por me forcën për të mos u dorëzuar. Ai mbetet një figurë e ndritur, që me

dinjitet ka kaluar vitet e vështira dhe ka mbajtur gjithmonë në zemër dashurinë për shërbimin, respektin për shokët dhe lidhjen e pathyeshme me vendin e tij.

Takimi ynë pas dyzetë vitesh nuk ishte thjesht një takim shokësh të vjetër. Ishte një udhëtim i brendshëm, një rikthim tek vlerat, tek besa dhe tek kujtesa që nuk shlyhet. Dhe mbi të gjitha, ishte një dëshmi se miqësia dhe respekti, ashtu si flamuri që valëvitet përjetë, nuk plaken kurrë.



KAPITEN (P) VERI TALUSHLLARI

Në epokën moderne, hapësira po përjeton transformimin e saj nga një arenë kërkimesh shkencore në një dimension strategjik të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet bashkëpunimit mes US Space Force dhe startup-it Gravitics, kanë nisur ndërtimin e një Transportuesi Ajror Orbital (Orbital Air Transporter) – një platformë e re që pritet të ndryshojë paradigmat e vendosjes dhe menaxhimit të mjeteve hapësinore.

Ky projekt, me vlerë mbi 60 milionë dollarë, përfaqëson një fazë të avancuar të militarizimit të hapësirës, por njëkohësisht edhe një përpjekje për të ruajtur epërsinë teknologjike dhe strategjike të SHBA-ve, përballë fuqive të tjera në ngritje.

### Konteksti strategjik dhe racionaliteti i nismës

Në dekadën e fundit, rivalitetet hapësinore janë intensifikuar në mënyrë të dukshme. Kina, Rusia dhe disa shtete të tjera kanë zhvilluar platforma orbitale dhe kapacitete kundër-satelitore (ASAT) që sfidojnë supremacinë amerikane në orbitë. Kjo ka shtyrë SHBA-të të zhvendosin fokusin e strategjisë së tyre të sigurisë nga dominimi tokësor dhe ajror drejt atij hapësinor.

Në këtë kuadër, Transportuesi Ajror Orbital paraqet një zgjidhje inovative për siguri të qëndrueshme hapësinore, duke ofruar fleksibilitet, mbrojtje dhe shpejtësi në vendosjen e mjeteve satelitore në orbitë. Projekti synon të adresojë nevojat emergjente për reagim të shpejtë në rast krize apo konflikti hapësinor.

### Dimensioni teknologjik dhe avantazhi operacional

Transportuesi Ajror Orbital është konceptuar si një platformë shumë-përdorimesh orbitale, e aftë të strehojë satelitë në kushte të mbrojtura nga ndikimet e jashtme të hapësirës (rrezatim, mikro-meteorite, ndryshime ekstreme termike).

Kjo teknologji parashikon: Vendosje direkte të satelitëve nga orbita, pa nevojën e lëshimeve të përsëritura nga Toka. Mbrojtje fizike dhe kibernetike të instrumenteve delikate elektronike dhe sistemeve të komunikimit. Kapacitet për fshehje (stealth) që e bën të vështirë zbulimin nga sistemet kundërshtarë të vëzhgimit orbital. Kjo përbën një avantazh të rëndësishëm në një epokë ku aftësia për të “fshehur” dhe mbrojtur mjetet hapësinore është po aq e rëndësishme sa dhe aftësia për t’i përdorur ato.

Siç theksoi Colin Doughan, drejtori ekzekutiv i Gravitics, kjo platformë është një “game-changer” në arkitekturën e mbrojtjes hapësinore, duke ofruar një mënyrë të re të manovrimit strategjik dhe operacional në orbitë.

### Bashkëpunimi publik–privat dhe impakti mbi ekonominë e hapësirës

Ky projekt nuk është vetëm një investim ushtarak, por edhe një model i bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik dhe privat, që tashmë është bërë tipar i rëndësishëm i politikës hapësinore amerikane.

Në bashkëpunim me kompani si Axiom Space, Gravitics po ndërton module hapësinore të avancuara që mund të përdoren

# Transportuesi Ajror Orbital: Teknologjia e re për dominimin hapësinor dhe sfida e paqes globale



jo vetëm për qëllime mbrojtëse, por edhe për kërkime shkencore dhe misione tregtare.

Ky bashkim i interesave ushtarake dhe civile nxit zhvillimin e një tregu të ri ekonomik – “ekonomia orbitale” – që pritet të transformojë mënyrën si njerëzimi përdor hapësirën për komunikim, vëzhgim dhe mbrojtje.

Megjithatë, ai ngre pyetje të rëndësishme mbi rregullimin ligjor dhe etikën e militarizimit të infrastrukturës komerciale.

### Dimensioni politik dhe ndërkombëtar i sigurisë hapësinore

Nga pikëpamja gjeopolitike, ky zhvillim sinjalizon një hap të ri në garën për dominim hapësinor. SHBA po përpiqet të sigurojë epërsinë e saj përballë përpjekjeve të Kinës dhe Rusisë për të ndërtuar arkitektura të ngjashme mbrojtjeje orbitale.

Megjithatë, kjo dinamikë ka pasoja të ndjeshme për stabilitetin strategjik global. Hapësira, që dikur shihej si një hapësirë e bashkëpunimit paqësor ndërkombëtar, po kthehet gjithnjë e më shumë në një zonë konkurrimi të fuqive të mëdha.

Në mungesë të marrëveshjeve të detyrueshme ndërkombëtare për kontrollin e armatimeve në orbitë, ekziston rreziku që veprime të tilla të nxisin një garë të re armatimesh hapësinore, me pasoja të paparashikueshme për sigurinë globale.

### Etika dhe e ardhmja e hapësirës si “Frontierë e Paqes”

Një nga pyetjet më të ndërlikuara që ngrihet nga ky zhvillim është:

Si mund të sigurohet që hapësira të mbetet një mjedis paqësor dhe në shërbim të njerëzimit, përtej interesave të ngushta kombëtare dhe ushtarake?

Nëse Transportuesi Ajror Orbital shihet vetëm si instrument ushtarak, ai mund të thellojë ndarjet globale. Por, nëse zhvillohet me parime të transparencës, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe përdorimit të përbashkët të teknologjisë, mund të shërbejë si bazë për një ekuilibër të ri të sigurisë hapësinore.

Këtu qëndron edhe sfida më e madhe e politikës globale të shekullit XXI: ruajtja e karakterit civil, etik dhe bashkëpunues të hapësirës përballë presioneve të militarizimit.

Transportuesi Ajror Orbital i Gravitics përfaqëson një kthesë historike në teknologjinë dhe strategjinë hapësinore të SHBA-së. Ai kombinon inovacionin inxhinierik me vizionin strategjik për dominim në një fushë që po bëhet çdo ditë e më jetike për sigurinë globale.

Megjithatë, kjo arritje mbart edhe përgjegjësi të mëdha. Hapësira nuk mund të shihet vetëm si një zgjatim i fushëbetejës, por si një pasuri e përbashkët e njerëzimit, që kërkon balancë midis fuqisë, etikës dhe bashkëpunimit.

Në këtë kuptim, sfida e vërtetë nuk qëndron vetëm në aftësinë për të ngritur platforma orbitale, por në aftësinë për të ruajtur paqen orbitale – një paqe që do të përcaktojë jo vetëm sigurinë e kombeve, por edhe drejtimin e progresit njerëzor në dekadat që vijnë.

Përshtatur për gazetën “Ushtria”

# Kruriozitete të jetës së fshehtë

Ushtria është një botë më vete. Përtej uniformave, stërvitjes dhe disiplinës, ajo fsheh një univers të pasur me tradita, zakone, teknologji dhe histori që shpesh mbeten të panjohura për publikun e gjerë. Ky artikull sjell disa nga kuriozitetet më interesante që lidhen me jetën ushtarake, duke hedhur dritë mbi anën më të veçantë dhe ndonjëherë të çuditshme të shërbimit në uniformë.



## Uniforma që flet pa fjalë

Në ushtri, uniforma nuk është thjesht veshje – është një gjuhë më vete. Çdo detaj, nga ngjyra e beretës te simboli në jakë, tregon gradën, njësinë, specializimin dhe shpeshherë historinë e shërbimit të një ushtari. Në disa vende, si SHBA apo Britania e Madhe, ekzistojnë kode të detajuara që lejojnë identifikimin e një ushtari vetëm duke parë uniformën e tij. Edhe në Shqipëri, gradat dhe shenjat dalluese janë të standardizuara, duke i dhënë uniformës një funksion komunikues.



## Ora biologjike ushtarake

Ushtarët stërviten të funksionojnë pa orë. Në misione ku nuk ka akses në teknologji, ata mësojnë të orientojnë me pozicionin e diellit, hënës apo tingujve të natyrës. Disa ushtarë zhvillojnë një ndjeshmëri të veçantë për kohën, duke e ndjerë atë me saktësi



të habitshme. Në stërvitjet e natës, kjo aftësi bëhet jetike për koordinimin e lëvizjeve dhe ruajtjen e ritmit operacional.

## Racionet ushtarake, më shumë se ushqim

Racionet ushtarake janë të dizajnuara për të përballuar kushtet më ekstreme. Ato përmbajnë kalori të larta, përbërës që nuk prishen lehtë dhe shpesh përfshijnë edhe elementë psikologjikë – si çokollata, letra motivuese apo lodra të vogla për moralin. Në Shqipëri, racionet janë përshtatur për klimën dhe terrenin, duke përfshirë ushqime të lehta për transport dhe të pasura në proteina. Disa racionet përmbajnë edhe çaj mali, një element tradicional që sjell ndjesinë e “shtëpisë” në terren.



## Stërvitja mendore, më e fortë se fiziku

Ndërsa stërvitja fizike është e dukshme, ajo mendore është po aq e rëndësishme. Ushtarët kalojnë nëpër simulime stresuese, vendimmarrje në sekonda dhe trajnim për të përballuar izolimin, frikën dhe pasigurinë. Në misione të vështira, aftësia për të ruajtur qetësinë dhe për të vepruar me logjikë është shpesh më e rëndësishme se forca fizike. Në akademitë ushtarake, psikologjia luan një rol kyç në formimin e liderëve të ardhshëm.



## Teknologjia që ndryshon gjithçka

Dronët, sistemet GPS, komunikimi satelitor dhe inteligjenca artificiale po transformojnë mënyrën si operon ushtria. Në Shqipëri, përdorimi i dronëve për vëzhgim kufitar dhe patrullim ajror është rritur ndjeshëm, duke sjellë efikasitet dhe siguri më të lartë. Po ashtu, sistemet e komandimit elektronik dhe simulimet digjitale po zëvendësojnë metodat tradicionale të stërvitjes, duke e bërë përgatitjen më të saktë dhe më të sigurt.



## Traditat e pazakonta

Ushtria ka tradita që i ruan me fanatizëm. Në disa vende, ushtarët e rinj kalojnë nëpër “rituale të pranimit” që përfshijnë sfida fizike dhe mendore. Në Shqipëri, ceremonia e betimit është një moment solemn dhe emocional, ku ushtari zotohet për mbrojtjen e atdheut. Në disa njësi, ekzistojnë edhe zakone të brendshme, si dhurimi i një simboli pas përfundimit të një misioni apo festimi i ditëlindjes së njësisë me aktivitete të veçanta.



## Ushtria dhe shkencat: një lidhje e pazakontë

Shumë inovacione shkencore kanë lindur nga nevojat ushtarake. Interneti, GPS-i, dhe shumë të tjera kanë origjinë ushtarake. Në Shqipëri, bashkëpunimi me universitete për zhvillimin e pajisjeve të reja, uniformave të avancuara dhe metodave të trajnimit është në rritje. Kjo tregon se ushtria nuk është vetëm një strukturë mbrojtëse, por edhe një nxitëse e progresit teknologjik dhe shkencor.



## Gruaja në ushtri: një histori që po shkruhet

Roli i grave në ushtri ka evoluar ndjeshëm. Në Shqipëri, gratë përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të trupave ushtarake, duke shërbyer si oficerë, pilote, mjeke dhe instruktore. Ato marrin pjesë në misione ndërkombëtare dhe stërvitje të avancuara, duke dëshmuar se profesionalizmi nuk ka gjini. Një nga kuriozitetet më të bukura është se në disa raste, gratë kanë udhëhequr njësi të tëra në operacione të ndërlikuara, duke fituar respekt dhe admirim brenda dhe jashtë vendit.



## Një botë që meriton të njihet

Ushtria është më shumë se një institucion – është një mënyrë jetese, një sistem vlerash dhe një burim i pashtershëm kuriozitetesh. Nga uniforma te teknologjia, nga traditat te sfidat mendore, çdo aspekt i jetës ushtarake fsheh histori që frymëzojnë, habisin dhe edukojnë. Njohja e këtyre kuriozitetëve na afron më shumë me ata që shërbejnë dhe na kujton se pas çdo parade, ka një njeri që ka zgjedhur të mbrojë me nder.

# Dokumentet zbulojnë që BE-ja synon të vendosë një mur prej dronësh përgjatë kufirit me Rusinë deri më 2027

BE-ja planifikon që të ketë të ashtuquajturin “mur dronësh” plotësisht funksional dhe të integruar brenda një “aftësie dronësh të bazuar në rrjet” deri në fund të vitit 2027, sipas Udhërrëfyesit të Gatishmërisë së Mbrojtjes 2030, të parë nga Euronews.

Dokumenti bazohet në muaj bisedimesh midis ekzekutivit të BE-së dhe shteteve anëtare për të ripërtërirë plotësisht politikën e mbrojtjes së bllokut përballë një Rusie gjithnjë e më agresive.

BE-ja ka përcaktuar tashmë një listë me nëntë fusha prioritare të aftësive për shtetet anëtare që të investojnë urgjentisht, duke përfshirë municionet, dronët dhe teknologjinë anti-dron, me Komisionin që gjithashtu propozoi në fillim të këtij muaji që katër projekte kryesore pan-evropiane të priorizohen.

Ai i listoi ato si Mbikëqyrja e Krahut Lindor, duke përfshirë Murin Evropian të Dronëve, Mburoja e Mbrojtjes Ajrore dhe një Mburoja Hapësinore e Mbrojtjes.

Udhërrëfyesi jep një afat kohor të parë se kur Komisioni vlerëson se këto mund të jenë gati dhe funksionale. Ai thotë se krahu lindor dhe muri i dronëve “janë më urgjentët”.

Ai gjithashtu parashikon që ky i fundit të jetë plotësisht funksional dhe i integruar brenda një aftësie droni të bazuar në rrjet - deri në fund të vitit 2027,” me të parin funksional “deri në fund të vitit 2028”.

“Aftësitë kundër-droneve do të projektohen si një sistem shumështrësor, teknologjikisht i përparuar me aftësi ndërvepruese anti-dron për zbulimin, gjurmimin dhe neutralizimin, si dhe aftësi për të goditur objektiva tokësore duke përdorur teknologjinë e dronëve për sulme precize”, thuhet në dokument.

“Kapaciteti i kundër-droneve duhet të jetë plotësisht i ndërveprueshëm dhe i lidhur midis shteteve anëtare, duke ofruar ndërgjegjësim evropian për situatën dhe aftësinë për të vepruar së bashku dhe për të siguruar infrastrukturën kritike së bashku me NATO-n”, shton ai.

Ai gjithashtu jep më shumë qartësi mbi temën e lëvizshmërisë ushtarake, e cila është përcaktuar si një fushë tjetër prioritare dhe e cila do të jetë objekt i një pakete tjetër që do të publikohet muajin e ardhshëm.

## Si të financohet muri

Në planin rrugor, Komisioni pret që “një zonë lëvizshmërie ushtarake në të gjithë BE-në, me rregulla dhe procedura të harmonizuara dhe një rrjet korridoresh tokësore, aeroportesh, portesh detare dhe elementesh mbështetës që sigurojnë transport të papenguar të trupave dhe pajisjeve ushtarake në të gjithë bashkimin, në koordinim të ngushtë me NATO-n” do të krijohet “deri në fund të vitit 2027”.



Foto e marrë nga videoja e shpërndarë nga Shërbimi i Shtypit i Ministrisë së Mbrojtjes Ruse.  
© AP Photo/Shërbimi i Shtypit i Ministrisë së Mbrojtjes Ruse

Aktualisht, disa shtete anëtare kërkojnë 45 ditë për të përpunuar kërkesat e vendeve të tjera të BE-së për të lëvizur trupa ose pajisje ushtarake brenda kufijve të tyre.

Qëllimi i iniciativave të ndryshme të mbrojtjes të paraqitura nga Komisioni deri më tani, duke përfshirë një skemë kredie për mbrojtjen, të quajtur SAFE, ka qenë të nxisë prokurimin e përbashkët të kapaciteteve ushtarake dhe të mbështesë Bazën Teknologjike dhe Industriale të Mbrojtjes Evropiane (EDTIB).

Ai beson se kjo mund të ulë kostot, të përshpejtojë dërgesat dhe të rrisë ndërveprimin midis forcave të armatosura të shteteve anëtare.

Udhërrëfyesi ofron objektiva të rinj me shtetet anëtare që u kërkohet të “organizojnë të paktën 40% të prokurimit të mbrojtjes si prokurim të përbashkët - deri në fund të vitit 2027” dhe të “prokurojnë të paktën 60% të buxhetit të tyre të prokurimit të mbrojtjes nga EDTIB dhe nga Ukraina - deri në fund të vitit 2030”.

Por udhërrëfyesi nuk arrin të identifikojë burime të reja financimi për të financuar rritjen e mbrojtjes evropiane, pavarësisht

thirrjeve nga shtete të ndryshme anëtare.

Ajo vetëm përsërit se propozimi i saj për buxhetin e ardhshëm shumëvjeçar të bllokut planifikon të rrisë fondet e mbrojtjes në 131 miliardë euro, me mobilitetin ushtarak që merr 18 miliardë euro, nga 1.76 miliardë euro në buxhetin aktual.

Në vend të kësaj, ajo përsëri kërkon përparim në një Union Kursimesh dhe Investimesh në mënyrë që të lehtësojë investimet private në sektor dhe reklamën financim shtesë nga Banka Evropiane e Investimeve (BEI), siç është një “fond fondesh” prej 1 miliard eurosh në kapital për të mbështetur rritjen e shpejtë të shkallëzimeve të lidhura me mbrojtjen dhe projekteve të lidhura me mbrojtjen që duhet të ngrihen para fundit të vitit.



Gazeta "Ushtria" - në shërbim të vlerave kombëtare, dinjitetit dhe paqes.

**Redaksia e gazetës**

Pikëpamjet, opinionet dhe analizat e shprehura në gazetën "Ushtria" janë tërësisht të gazetarëve apo autorëve të materialeve respektivë, sjellë pranë redaksisë së kësaj medie dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë politikën apo pozicionet zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.



## Qendra e Personel Rekrutimit njofton se do të rekrutojë kandidatë për studime në Akademitë Ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës

JANË NË DISPOZICION 3 (TRE) TË  
DREJTA STUDIMI, SI MË POSHTË:

- ⚓ Akademia Ushtarake "West Point"
- ✂ Akademia Ushtarake Detare
- Akademia Ushtarake e Forcave Ajrore

1 (një) kuotë  
1 (një) kuotë  
1 (një) kuotë

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është 14 nëntor 2025.

Për më shumë informacion, ju lutem na kontaktoni në numrin e  
tel. 0035542348588,  
WhatsApp +355 68 340 4896